

P.nr. 2645/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuares A. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KP-së, sipas aktakuzes te Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.2958/2016, të datës 30.11.2016, pas mbajtjes së seancës kryesore gjyqesore, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Musli Gashi, të akuzuares, me datë **24.10.2017**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara A. K., nga i ati E. dhe e ëma S., e vajzërisë B., i lindur më datë 23.11.1997 në Q., tani me banim ne Prizren rr. nr. , amvise, ka të kryer shkollen e mesme, e martuar nene e 2 femijeve, i gjendjes se dobet ekonomike, turke, shtetase e Republikës së Kosoves.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Se me date 09.11.2016, ne kohe te pa vertetuar, ne Prizren, ne rrugen S. B. me qellim te pervesimit te kunderligjshem te pasurise, ia merr pasurin e luajtshme te demtuares V. H. ne ate menyre qe shfrytezon mos prezencen e te demtuares, hyne ne dhomen e fjetjes nga ku merr stoli ari: nje dy lira e gjysme (2/5), 2 hallka, dy lira, prone e te demtuares, duke i shkaktuar te demtuarit dem material.

-kësodore kane kryer vepren penale vjedhje nga neni 325 par.1 te KP-es.


Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, par.1 pika 1.3, 46, 49 par.1.1, 50, 51, 73, 74, 75 e 76 te KP-se, dhe neni 365 te KPPK-es te akuzuares i shqipton:

D E N I M M E G J O B E

Ne lartesi prej **200 eurove**, te cilen shume e denimit eshte e obliguar qe te paguaje ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, denimin me gjobe e akuzuara do ta paguaj ne 3 kiste, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njeiti do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo **20 euro** nje dite burg, rrespektivisht denim burgimi prej 10 diteve, dhe

D E N I M M E K U S H T

Ashtu qe i verteton denimin me burg ne kohezgjatje prej **1 viti**, i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej **2 vite**, nga dita e plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi nese i akuzuari nuk kryen veper te re penale,



E akuzuara obligohet që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, ndërkaq në emër të paushallit gjygjësor shumë prej **50 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

E demtuara V. H. nga Prizri nr. , per realizimin e kerkeses pasurore-juridike udhezohet ne kontest te rregullt civilo-juridik,

A r s y e t i m


Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me nr. PP.nr.2958/2016, të datës 30.11.2016, kunder te akuzuares A. K. nga Prizreni, per shkak te vepres penale vjedhje nga neni 325 par.1 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares e cila vullnetarisht e kane pranuar fajsin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se e akuzuara ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila iu vihete ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat e akuzuara ka qene e njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuares formohen te gjitha elementet e vepres penale te vjedhjes, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 te KP-es, dhe per kete gjykata te akuzuaren e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe dhe me kusht si te merituar, paraprkisht duke e vertetuar pergjegjesine e tyre penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuares gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares, e ne kuptim te dispozitave te nenit 74, 75 e 76 e akuzuara ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i saj ka qene vullnetare ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin si dhe ka shprehur keqardhje per vepren e kryer penale, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i saj, gjendja e dobet ekonomike, amvise, nene e 2 femijeve, sendet e vjedhura-arin ia ka kthyer te demtuares, gjer me tani e pa gjykuar, çka nenkupton se nuk kane ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqipton denimin me gjobe e me kusht te akuzuares, sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi i denimit, prandaj i shqipton denimin me gjobe e me kusht, ashtu qe i verteton denimin me burgim ne kohezgjatje prej 1 viti, i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 2 viteve, nese e akuzuara nuk kryene veper te re penale, ku gjykata konsideron se me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise dhe e akuzuara duhet qe ne te ardhmen te jete e kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla te karakterit penal.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450 e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 2645/2016 të datës 24.10.2017

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi pala e pakenaqr ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.

